Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 258/01
Datë: 24.07.2014

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohet lista e eksperteve të jashtëm për periudhën dy vjeçare për këto sektorë dhe profile si në vijim:

   Nga sektori i Administrim Biznesit, për profilin:
   1. Asistent Administrativ

   Nga sektori i makinerisë, për profilin:
   1. Metalpunues/Saldues

   Nga sektori i ndërtimtarisë, për profilet:
   1. Instalues elektrik
   2. Instalues i ngrohjes qendrore
   3. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
2. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka të drejtë që të përzgjedhe ekspertët nga listë varësisht sipas nevojës.

3. Aprovohet fillimi i procesit të validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve që ofojnë këto kualifikime nga këta sektorë:

   Nga sektori i Administrim Biznesit, për profilin:
   1. Asistent Administrativ

   Nga sektori i makinerisë, për profilin:
   1. Metalpunues/Saldues

Nga sektori i ndërtimtarisë, për profilet:

1. Instalues elektrik
2. Instalues i ngrohjes qendrore
3. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit

4. Të hapet ftesa për aplikim të ofruesve dhe konkursi për ekspertë të jashtëm për validim të kualifikimit secilin sektor dhe profil të këtyre profileve të përmendura më lartë.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi